



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:107215
Datë: 02.06.2022
Numri i dokumentit: 03092973
CPK.nr.100/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Besnik Pireva, ne çështjen përmbartimore të kreditorit S.S. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson i autorizuari Fadil Sinanaj avokat në Gjilan, kundër debitorit Komuna e Gjilanit-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, për pagesën e shpenzimeve të procedurës sipas titullit ekzekutiv C.nr.2341/2020, dt.30.12.2020, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, kundër urdhrit të përmbartuesit privat K.M. nga Gjilani, P.nr.353/22 të datës 28.04.2022, jashtë seance, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Refuzohet në tersi si i pabazuar, prapësimi i debitorit Komuna e Gjilanit-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, i parashtruar kundër urdhrit të përmbartuesit privat K.M. në Gjilani, P.nr. 353/22 të datës 28.04.2022, për caktimin e përmbartimit të dhunshëm.

II. Obligohet, debitori i përmbartimit Komuna e Gjilanit-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, në emër të përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit S.S. nga Gjilani shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumën 117 euro.

A r s y e t i m

Kreditori ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit me 22.04.2022 ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.2341/2020, dt.30.12.2020, i plotfuqishëm me datë 18.01.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2022, për pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 134.00 euro, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumë prej 117 euro.

Organi përmbartues-përmbartuesi privat K.M. në Gjilani, duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar përmbartimin me urdhër P.nr 353/22 të datës 28.04.2022.

Debitori në afatin e paraparë ligjor me datë 06.05.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, duke theksuar se propozimit për përmbarim të kreditorit i mugun baza ligjore, nga fakti se sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore (më tej: LPP), kompetencë për zbatimin e vendimeve nga marrëdhënia e punës është Gjykata Themelore- Zyra përmbarimore. Gjithashtu ka theksuar se ky propozim është në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 465 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK), duke i propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të përfundohet/anulohen të gjitha veprimet në lidhje me këtë propozim.

I autorizuar i kreditorit, me datë 12.05.2022, ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit dhe i ka kundërshtuar në tërësi kundërshtimet e paraqitura nga debitori, duke theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se për zbatimin e këtij vendimi është kompetent gjykata dhe jo përmbaruesi privat, për arsye se nuk kemi të bëjmë fare me çështje nga marrëdhënia e punës, pasi që me propozimin ka kërkuar vetëm shpenzimet e procedurës kontestimore, pasi që debitori në këtë procedurë ka paguar vetëm kryegjënë, ndërsa jo dhe shpenzimet e procedurës të cilat janë shkaktuar me fajin e tij. Sa i përket pretendimit tjetër se propozimi për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e LPK, konsideron se ky pretendim nuk qëndron nga se vendimi tashmë është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm dhe tani jemi në procedurën e përmbarimit dhe se këto pretendime debitori është dashur ti praqes në procedurën kontestimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar në ligj prapësimi i debitorit, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 117 euro.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, si dhe thënieve të debitorit në prapësim dhe përgjigjes së kreditorit në prapësimin e debitorit, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit i parashtruar kundër Urdhrit për përmbarim, është tërësisht i pa bazuar, pasi që nga shkresat e lëndës së përmbarimit, gjykata si organ kompetent për vendosje për prapësimet e ushtruar kundër urdhrave për përmbarim të përmbaruesit privat, si në rastin konkret, vërtetoi faktin se debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështet në asnjë provë, siç është paraparë me nenin 69 paragraf. 4 të LPP sipas të cilit nen është përcaktuar qartë se baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura.

Gjykata vlerësoi se dokumenti përmbarues –aktvendimi i C.nr.2341/2020, dt.30.12.2020, i plotfuqishëm me datë 18.01.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2022, është titull ekzekutiv në të cilat janë treguar të gjitha të dhënat për llojin e detyrimit, palën përgjegjëse për përmbushje të detyrimit, më gjerësisht si në pikën II. të dispozitivit të dokumentit përmbarimor ashtu siç është paraparë në nenet 21, 22, 23, dhe nenin 24 të LPP, andaj në bazë të cekurave më lartë pala kreditore ka bërë propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të përmbarimit të përmbaruesit privat, si organ i përmbarimit, gjë që në bazë të cilit dokument është lejuar përmbarimi nga përmbaruesi privat.

Pretendimet e debitorit të parashtruara në prapësim, anë të pabazuara nga se objekt përmbarimi është aktvendimi i gjykatëse, konkretisht pika II. e dispozitivit, ku është vendosur vetëm për

shpenzimet e procedurës kontestimore dhe nuk është vendosur për çështjen kryesore dhe as në mënyrë meritore.

Gjykata po ashtu nuk i mori parasysh edhe pretendimin tjetër të paraqitur në prapsim se urdhri përmbartimor është në kundërshtim me nenin 465 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, nga se duke ju referuar edhe parimit të legalitetit rigoroz formal, ku gjykata në procedurë përmbartimore nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale dhe të rregullsisë së dokumentit përmbartimor (titullit ekzekutiv), në bazë të cilit e lejon përmbartimin, dhe se të njëjtat pretendime është dashtë të parashtrohen në procedurën kontestimore para se vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Gjykata, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi vendosi në pajtim me nenin 452.1 dhe 463 të LPK, lidhur me nenin 17 dhe 13.4 të LPP, sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata, mbi bazën e asaj që është thënë më lart dhe, në bazë të nenit 44 par.3 dhe 73 të LPP, vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
CPK.nr.100/2022, datë 02.06.2022

G j y q t a r i,
Besnik Pireva

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.